

---

# E ARDHMJA EVROPIANE E MAQEDONISË FILLON ME KAPITULLIN 23

## Dokument i shkurtër mbi politikë publike

---

### Për dokumentin

Ky dokument i shkurtër mbi politikë publike bazohet në qëndrimet e shprehura në konferencën finale të projektit Rrjeti 23+, që u mbajt më 5 qershor, me titullin “Kapitulli 23: Kuti e Pandorës apo çelës për sundim të drejtë?”. Konferenca përbëhej nga katër sesione, sipas strukturës së Kapitullit 23, për të cilat debatuan politikanë, ekspert, folës nga më shumë institucione, organizata dhe partnerë ndërkombëtar, me qëllim të përcaktimit të mirëfilltë të gjendjes në Republikën e Maqedonisë, si dhe hapat më të rëndësishëm të cilët, gjatë periudhës së ardhshme, duhet t’i ndërmerren shteti.

Instituti për politikë evropiane - Shkup  
network23@epi.org.mk

---

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze në Beograd, ndërsa kjo ngjarje u mbështet nga Komuna Qendër. Mendimet e paraqitura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e donatorëve.

## Hyrje në konferencë

Kapitulli 23, i cili e përfshinë jurisprudencën, luftën kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore të qytetarëve është Kapitulli i parë i cili hapet në negociatat me Bashkimin Evropian, bashkë me Kapitullin 24. Në këtë mënyrë, Unioni e thekson rëndësinë e parimit të sundimit të së drejtës, si një nga vlerat më të rëndësishme të tij. Për këto arsye, me rëndësi të madhe është të diskutohen gjendjet dhe sfidat të cilat pasojnë në Kapitullin 23, veçanërisht të theksuara para miratimit të Vendimit të Këshillit të Evropës për fillimin eventual të negociatave me BE.

Konferenca përfundimtare e projektit “Rrjeti 23+”, [e cila u mbajt më datë 5 qershor](#), me titullin “**Kapitulli 23: Kutia e Pandorës ose çelësi i sundimit të mirë?**”, përbëhej nga 4 sesione sipas strukturës së Kapitullit 23. Në këto sesione debatuan politikanë, ekspertë, folës nga më shumë institucione, organizata dhe partnerë ndërkombëtar, me qëllim të përcaktimit të mirëfilltë të gjendjes në Republikën e Maqedonisë, si dhe hapat më të rëndësishëm të cilët, gjatë periudhës së ardhshme, duhet t’i ndërmerr shteti. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd, ndërsa kjo ngjarje u mbështet nga Komuna Qendër.



Fjalë hyrëse mbajtën Kryetari i Qeverisë së RM-së, z. Zoran Zaev, Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, z. Bujar Osmani, Ministrja e Drejtësisë, Dr. Renata Deskoska, Kryetari i Komunës Qendër, z. Sasha Bogdanoviq, si dhe Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, Kryetar i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe profesor në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë”. Konferencën e hapi Dr. Simonida Kacarska, Drejtoreshë e Institutit për Politikë Evropiane.

Dr. Kacarska u shprehu falënderim të gjithë atyre që morën pjesë në punën e këtij projekti, i cili përfshin një Kapitull të rëndësishëm të negociatave me Bashkimin Evropian. “Në këtë projekt nuk punoi vetëm Instituti për Politikë Evropiane dhe Komiteti i Helsinkit, por të njëjtin e punuam në partneritet me 15 anëtarët e tjerë të Rrjetit 23, 9 grantistë, institucionet dhe nëpunësit shtetërorë. Jemi të kënaqur se me

ne është Ministria e Drejtësisë dhe Sekretariati për Çështje Evropiane, të cilët janë partnerë tanë, bashkë me Avokatin e Popullit, institucionet gjyqësore dhe shoqatat profesionale”, theksoi Kacarska. Ajo shtoi se “parimi i punës, siç është Rrjeti 23, është të punojmë në partneritet me nëpunësit shtetërorë”, meqë vetëm në këtë mënyrë do të mund të bëhet ndryshimi i qëndrueshëm në shoqëri.

Në fjalën e tij, Kryetari i Qeverisë, z. Zoran Zaev, potencoi se korrupsioni nuk duhet të ketë vend në Republikën e Maqedonisë, e as në cilindo shtet tjetër, megjithatë që i njëjti të çrrënjoset nevojitet shumë punë. “Republika e Maqedonisë është shtet i cili do të udhëhiqet sipas rregullave evropiane”, tha z. Zaev”, dhe si e tillë doemos duhet të siguroj qasje në drejtësi, e cila do të garantohet plotësisht, mjedis në të cilin grupet më vulnerabile do të mund t’i shfrytëzojnë mekanizmat të cilët i kanë në dispozicion, me qëllim që të kenë besim më të madh ndaj jurisprudencës së shtetit në të cilin jetojnë”. Ai, në fjalën e tij, e potencoi rolin e Rrjetit 23 në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. “Rekomandimet dhe ndikimi i organizatave qytetare të Rrjetit 23 zënë vend të rëndësishëm në procesin e integritimit tonë në Bashkimin Evropian, përmes përfshirjes aktive dhe gjatë monitorimit dhe evaluimit të politikave të Kapitullit 23”, theksoi z. Zaev. Në fund të diskutimit të tij, z. Zaev i ftoi organizatat qytetare që bashkë me Qeverinë të ndërtojnë sistem i cili nuk do të toleroj korrupsion dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

Rruga e Maqedonisë drejt BE-së është e gjatë, por nuk është e pafund, konstatoi z. Bujar Osmani, Zëvendëskryetar i Qeverisë për Çështje Evropiane. Anëtarësimi është një proces i transformimit të shoqërisë, megjithatë Republika e Maqedonisë krahas faktit se një kohë të gjatë është bllokuar në këtë proces, asnjëherë nuk e ka ndërprerë transformimin e shoqërisë. Në një situatë kur shteti shënon progres në lidhje me sundimin e së drejtës, në krahasim me të kaluarën, Plani 18 është zgjidhje e përkohshme, i cili duhet të mundësoj rezultate deri në hapjen e negociatave me BE.

Ministrja e Drejtësisë, Dr. Renata Deskoska theksoi se Kapitulli 23 nuk duhet të perceptohet si Kutia e Pandorës, madje se edhe ajo personalisht është ithtare për reforma thelbësore meqë konsideron se të gjitha strategjitë dhe planet e veprimit janë materie e gjallë që ndryshohet. “Çdo hap gjatë implementimit të Kapitullit duhet të jetë një hap përpara drejt fuqizimit të së drejtës dhe besimit të qytetarëve në sistemin juridik”, deklaroi ajo.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e autoriteteve lokale, në realizimin e të drejtave të qytetarëve të BE, Kryetari i Komunës Qendër, Sasha Bogdanoviq, tha se qytetarët gjithnjë e më shumë e identifikojnë rolin e pushtetit lokal dhe se komunat mund t’i ndërtojnë kapacitetet e tyre vetëm përmes bashkëpunimit me faktorët e ndryshëm, në mesin e të cilëve edhe organizatat qytetare.

Profesori dhe Kryetari i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, Gordan Kallajxhiev, e nënvizoi nevojën e thellimit të reformave dhe përmbushjes së esencës së tyre të mirëfilltë. Sektori qytetar i qaset me entuziazëm të madh transformimit të sistemit të shtetit, por ekziston problem real në mosrespektimin e afateve të cilët përcaktohen në strategjitë e reformave.

## Reformat në jurisprudencë – forma apo esenca?



Folës: **Dr. Xhemali Saiti**, gjyqtar në Gjykatën Supreme dhe Kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve; **znj. Lençe Ristoska**, Prokurore Speciale Publike; **z. Voislav Gavrovski**, Zëvendës prokuror publik; **Prof. Dr. L Lazar Nanev**, gjyqtar dhe kryetar i Këshillit për Parandalimin e Delikuentës së të Miturve – grantist i Rrjetit 23+; **znj. Natali Petrovska**, Drejtoreshë e Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” – grantiste e Rrjetit 23+; **z. Zoran Jankullovski**, drejtor i Shoqatës së Punonjësve Financiar të Vetëqeverisjeve Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike – grantist i Rrjetit 23+; Moderatore: **znj. Gordana Duvnjak**, gazetare dhe redaktore e 1TV.

Panel diskutimi i parë u fokusua mbi reformat në jurisprudencë. Maqedonia në Raport progresin e vitit 2015 dhe të vitit 2016 të Komisionit Evropian (KE) ishte shënuar si shtet i kapur. Ky konstatim nga KE, veç tjerash, kishte të bëjë edhe me pushtetin gjyqësor të kapur, si pushteti i tretë në shtet, nga ana e pushtetit ekzekutiv. Në raportet e KE për vitin 2015 dhe 2016 jurisprudenca shënonte regres. Sistemi i jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë u kritikua edhe në raportet e Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga Pribe me adresimin e rekomandimeve konkrete për avancimin e të njëjtës. Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të adresuara në raportet e KE, si dhe nga Grupi i Ekspertëve të udhëhequr nga Pribe, Qeveria e re e RM-së filloi me zbatimin e aktiviteteve në pjesën e jurisprudencës të përcaktuara me [Planin 3-6-9](#). U përpilua [Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022](#), si bazë solide për reforma të mëtutjeshme dhe ndryshime ligjore.<sup>1</sup> Në përpilimin e Strategjisë u përfshinë shumë faktorë si dhe u pranuan vërejtjet e adresuara nga ana e Shoqatës së Gjyqtarëve dhe nga organizata të tjera relevante joqeveritare. Në prill të vitit 2018 u miratuan ndryshimet e Ligjit për

<sup>1</sup> Qëndrim të këtillë shprehu gjyqtari Xhemali Saiti dhe zëvendësi i Prokurorit Publik, Voislav Gavrovski.

gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Miratimit i paraprinë pazarllëqe politike, veçanërisht për Ligjin për gjykatat nga ana e dy partive më të mëdha politike. Në prill të vitit 2018, në Raportin e ri të KE u përcaktuan angazhimet e bëra në pjesën e jurisprudencës. Nëse bëjmë një krahasim rajonal Maqedonia me Shqipërinë kanë progres më të madh në pjesën e jurisprudencës. Edhe përkrah angazhimeve të nënvizuara nga ana e KE, shtrohet pyetja nëse reformat në pjesën e jurisprudencës perceptohen si trampolinë për reforma plotësuese thelbësore të cilat duhet të pasojnë së shpejti ose vetëm si reforma që kanë të bëjnë me formën dhe përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian. Në fjalimin hyrës, ministrja Renata Deskoska theksoi se në periudhën e ardhshme do të fokusohet mbi cilësinë e reformave të cilat duhet të realizohen në këtë fushë dhe jo vetëm mbi zbatimin e përciptë të reformave.

Nga diskutimi i pjesëmarrësve në panelin e parë mund të konkludohet se **reformat thelbësore në pjesën e jurisprudencës duhet të implementohen në periudhën në vijim**. Përmbajtja e reformave akoma paraqet sfidë. Folësit ranë dakord se Strategjia e reformave në sektorin e jurisprudencës është bazë solide për ndryshime të mëtutjeshme ligjore. Një hap pozitiv është edhe formimi i Këshillit për monitorimin e Strategjisë dhe përfshirja e të gjithë faktorëve relevantë në këtë Këshill.<sup>2</sup> Në mënyrë plotësuese në Strategji janë determinuar dobësitë në fusha konkrete, si dhe janë parashikuar masa për tejkalimin e të njëjtave. Spektri i parë i ndryshimeve të ligjeve fillon me shfuqizimin e Ligjit të Këshillit për përcaktimin e fakteve, si dhe ndryshimet e miratuara të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Megjithatë, sfidat kryesore janë akoma aktuale. Ndryshimet u kritikuan nga kasta gjyqësore, si dhe u paraqitën komente nga ana e Shoqatës së Gjyqtarëve. Gjyqtari Xhemali Saiti theksoi se ndryshimet e ligjeve janë bazë e mirë për reforma, duke theksuar se janë reale pritshmëritë e gjyqtarëve, por edhe vet gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e procesit reformues. Sipas gjyqtarit Lllazar Nanev, fokusi i ndryshimeve të ardhshme të Ligjit për gjykata duhet të jetë mbi **organikën dhe strukturën organizative të sistemit gjyqësor në RM**.

Prokurori Voislav Gavrovski theksoi se edhe krahas kompetencave të rritura të Prokurorisë Publike me LPP nga viti 2013, nuk u miratua ligj i ri për Prokurorinë Publike. Në rrjedhë e sipër është hartimi i ligjit të ri në të cilin marrin pjesë të gjithë faktorët kryesorë, kështu që draft-ligji është në fazë përfundimtare. Me këtë Ligj parashikohen kompetenca të reja për Prokurorinë Publike, përcaktohet përgjegjësia disiplinore e prokurorëve publikë, ndërkaq si çështje e veçantë është përfshirja e PSP në sistemin e Prokurorisë Publike.<sup>3</sup> Nevoja për inkorporimin e PSP në sistemin e Prokurorisë Publike u potencua edhe nga prokurorja Lençe Ristoska. Ajo gjatë diskutimit e potencoi punën e PSP në periudhën e kaluar, me vështrim të veçantë mbi punën ekipore dhe qasjen multidisciplinare, përkatësisht zhvillimin e hetimeve financiare paralelisht me ato kriminalistike. Nevojitet të vazhdohet puna e PSP, duke i pasur parasysh lëndët në kompetencë të PSP, si dhe duke e pasur në konsideratë kompleksitetin e tyre, ndërkaq duke e pasur parasysh faktin se edhe në nivel ndërkombëtar lëndët e këtilla zgjasin një kohë më të gjatë.<sup>4</sup> Prokurorja Ristoska theksoi se duhet të ruhet **autonomia e PSP në lidhje me rastet e korrupsionit të lartë**. Prokurori Voislav Gavrovski theksoi se janë paraqitur propozime konkrete për t'u bërë distinkcioni i kompetencave të PSP dhe

---

<sup>2</sup>Përfshirjen e Shoqatës së Gjyqtarëve në këtë Këshillit e potencoi gjyqtari Xhemali Saiti.

<sup>3</sup>Prokurori Voislav Gavrovski potencoi se për shkak të deficitit të kuadrit, Prokuroria Publike mund të pësojë kolaps, nëse nuk mundësohet zgjedhja e kuadrove të jashtëm si prokurorë publikë (para së gjithash sa u përket bashkëpunëtorëve ekspertë të prokurorive publike).

<sup>4</sup>Lençe Ristoska, Prokurore Publike. Në mënyrë plotësuese, prokurorja e theksoi praktikën e re gjyqësore me vendimet e Gjykatës së Apelit në Shkup, lidhur me lëndët e PSP, ku bisedat e përgjuara pranohen si provë në procedurë.

Prokurorisë Publike për kriminin dhe korrupsionin e organizuar, me qëllim që të mos ketë konflikt kompetencash, përkatësisht **PSP të ketë kompetencë në korrupsionin e lartë dhe veprat penale të kryera nga persona të zgjedhur dhe të emëruar**. Gjyqtari Lllazar Nanev e theksoi nevojën për miratimin e **Kodit të ri Penal** me të cilin do të përcaktohet minimumi dhe maksimumi i dënimeve.

Përveç nevojave për ndryshimet ligjore u theksua problemi i (mos)besimit të gjyqësorit. Transparenca është përforsimi kryesor i besimit të sistemit të jurisprudence, potencoi Natali Petrovska nga Koalicioni Të gjithë për Gjykim të Drejtë. Sipas hulumtimit lokal të realizuar në vitin 2016, 52% të indikatorëve për transparencë janë përbushur. Hulumtimi rajonal tregon se janë përbushur vetëm 33% të indikatorëve për transparencë dhe jemi vetëm para Shqipërisë, e cila ka përbushur 22% të indikatorëve për transparencë. Në drejtim të avancimit të transparencës në sistemin gjyqësor në proces është cikli i debateve të organizuara nga Shoqata e Gjyqtarëve për formimin e **trupit gjyqësor – mediatik/Këshill**, në të cilin do të vendosen kornizat e formimit të këtij trupi, i cili duhet të filloj me punë në muajin shtator.<sup>5</sup> Mes tjerash Dr. Saiti e theksoi nevojën e transformimit mendor të të gjithë protagonistëve në sistemin e jurisprudence. Transformimi i këtillë mendor u theksua edhe nga prokurorja Lençe Ristoska. Përmes vendosjes së profesionalizmit dhe integritetit, si dy parime themelore për veprimin e të gjithë punonjësve në jurisprudence, do të arrijmë në transformimin e vetëdijes për çështje të rëndësishme të kësaj natyre.<sup>6</sup> Nevojitet transformimi gjatë veprimit tek gjyqtarët dhe tek anëtarët e Këshillit Gjyqësor në lidhje me çështjet e zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve. Akoma zgjidhen dhe avancohen gjyqtarë politikisht të përshtatshëm. Në gjyqësor mungojnë gjyqtarë liderë të cilët do të ndikojnë që pushteti gjyqësor të profilizohet si pushteti i tretë i pavarur nga dy pushtetet e tjerë.<sup>7</sup> Nevojitet edhe vetëdije për implementimin e zgjidhjeve tanimë të përcaktuara ligjore.<sup>8</sup> Gjyqtari Nanev e theksoi **nevojën e unifikimit të praktikës gjyqësore në RM me theks të veçantë të rolit të Gjykatës Supreme**.<sup>9</sup> Ish gjyqtarja Margarita Caca Nikollovska theksoi se gjyqtarët në RM në nivel të pamjaftueshëm e aplikojnë praktikën e GJEDNJ.

Është i domosdoshëm fuqizimi i pavarësisë financiare të gjyqësorit.<sup>10</sup> Zoran Jankullovski theksoi se në vitin 2012 mjetet e planifikuara për pushtetin gjyqësor ishin 0.37% nga BPV, ndërsa në vitin 2016 ishin 0.3%, njëherësh theksoi se financimi i aktiviteteve të **pushtetit gjyqësor nuk guxon të jetë nën limitin prej 0.5% të BPV, me tendencë që të arrihet përqindja e parashikuar prej 0,8% nga BPV**.

---

<sup>5</sup>Dr. Xhemali Saiti, gjyqtar i Gjykatës Supreme dhe Kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve.

<sup>6</sup>Lençe Ristoska, Prokurore Publike.

<sup>7</sup>Gjyqtar Lllazar Nanev.

<sup>8</sup>Lençe Ristoska, Prokurore Publike.

<sup>9</sup>Nevoja e këtillë u potencua edhe nga ish-gjyqtarja Mirjana Ivanovska. Ish-gjyqtarja Millka Ristova e theksoi Rolin e Gjykatës Supreme për zhvillimin e opinionit kritik të zgjidhjeve të caktuara ligjore, si dhe nevojën e qëndrimeve të këtilla kritike të pranohen nga ana e pushtetit ekzekutiv.

<sup>10</sup>Dr. Xhemali Saiti. Kjo nevojë u theksua edhe nga Zoran Jankullovski, drejtor i SHPF. Nevoja për ndarjen e më shumë mjeteve për PP u potencua edhe nga prokurori Voislav Gavrovski.

## Nivel i lartë i korrupsionit, institucione të dobëta



Folës: **Dr. Rozeta Trajan**, Sekretare e Përgjithshme në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; **Prof. Dr. Misho Dokmanoviç**, Kryetar i Institutit për Hulumtime Strategjike dhe Edukim, si dhe profesor në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” – grantist i Rrjetit 23+; **znj. Ana Gjurniç**, nga Instituti Alternativa, Mali i Zi; **z. Vlladimin Mihajloviç**, Qendra për Politika Evropiane – Serbi; **z. Darko Popovski**, Instituti ZIP – grantist i Rrjetit 23+.

Moderatore: **znj. Gordana Duvnjak**, gazetare dhe redaktore e 1TV

Gjendja me luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë gjatë viteve të kaluara është vlerësuar si mjaft e dobët nga organizatat relevante vendase dhe të huaja, si dhe nga Komisioni Evropian. Sipas [indeksit të perceptimit të korrupsionit të Transparensi Interneshënël](#), Maqedonia, për vitin 2017, është vlerësuar me notën 35/100 pikë, ndërsa në vitin 2012 e ka pasur notën prej 42/100. Këto të dhëna e pozicionojnë shtetin tonë në fund të listës së rajonit sa i përket perceptimit të korrupsionit. Sondazhi i opinionit publik nga projekti Rrjeti 23+ tregon se 60% e qytetarëve konsiderojnë se gjendja është e keqe, ndërsa 46% e nëpunësve shtetërorë e kanë dhënë [mendimin e njëjtë](#).

**Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga diskutimet u identifikua si hallka më e dobët në luftën kundër korrupsionit.** Mbështetje të këtij konfirmimi mund të gjendet edhe në zbulimin

e indikatorëve për praktika korruptive në publik, të kryera nga ana e anëtarëve të KSHPK, me ç’rast një pjesë e tyre dhanë dorëheqje.<sup>11</sup>

“Publiku është kontrolluesi kryesor i veprimeve të institucioneve”, deklaroi Dr. Rozeta Trajan, në lidhje me raportet e keqpërdorimit të anëtarëve të KSHPK. Ajo deklaroi se duke i pasur parasysh rezultatet e dobëta të KSHPK, në maj të vitit 2018 u formua Grupi i Punës për hartimin e propozim Ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit. Ky Grup i Punës duhet ta ndryshoj statusin e këtij Komisioni, ta fuqizoj pavarësinë e tij dhe t’i rris kapacitetet për ushtrimin e kompetencave të veta.

Misho Dokmanoviq, profesor në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” dhe pjesë e Institutit për Hulumtime Strategjike dhe Edukim e prezantoi [hulumtimin e IHSE lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve](#), dhe përfaqësimin e korrupsionit në universitete. Të dhënat tregojnë se 7% e studentëve në vitin 2016 kanë qenë viktime të korrupsionit, ndërkaq madje **43% e studentëve kanë qenë dëshmitarë të ndonjë forme të korrupsionit**. Dëshpërues është fakti se 78% e studentëve të Fakultetit Juridik nuk do të denoncinin vepër korruptive, meqë nuk besojnë se denoncimi i tyre do të ketë efekt. “Ekziston mosbesim i lartë në mekanizmat e denoncimit dhe parandalimit të korrupsionit”, konstatoi Dr. Dokmanoviq. Ai shtoi se korrupsioni është inkorporuar në sistemin e jetesë në Maqedoni, dhe së këtejmi është vështirë të identifikohet.

Përvojat e Malit të Zi dhe Serbisë në luftën kundër korrupsionit nuk ofrojnë progres thelbësor në këtë fushë. Edhe pse rekomandimet formale të BE, SIGMA dhe ekspertëve vendas shpeshherë merren në konsideratë, megjithatë mungon implementimi faktik i këtyre rekomandimeve. “Mali i Zi shpeshherë prezantohet si lider i rajonit, madje edhe nga KE, por ne që i përkasim sektorit qytetar nuk jemi të mendimit se e meritojmë këtë epitet”, deklaroi Ana Gjurniq nga Instituti Alternativa nga Podgorica, bashkëpunëtore e projektit Rrjeti 23+. Përvoja e tyre tregon se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e themeluar në vitin 2016, e cila i ndërmori kompetencat nga dy trupa paraprak për ndjekjen e korrupsionit, nuk shprehu vullnet të mirëfilltë që ta hetoj korrupsionin e lartë. Vënia në dukje të një sërë parregullsive në punën e Agjencisë, afërsia e drejtorit të Agjencisë dhe të nëpunësve me partitë në pushtet, si dhe “pastrimi” ekspres i funksionarëve shtetërorë të cilët në publik janë akuzuar për korrupsion, tregon ngjashmëri me rastin në Maqedoni. Krahas pavarësisë së madhe financiare dhe kadrovike të cilën Agjencia në Malin e Zi tanimë e gëzon, nga ana tjetër mungon lufta efektive kundër korrupsionit, ndërsa Agjencia përdoret për qërim hesapësh politike.

Përvoja e Serbisë tregon se ekziston influencë e madhe politike në zgjedhjen dhe emërimin e nëpunësve shtetërorë, e që është bazë për zhvillimin e korrupsionit në administratën publike. Autorizimet e ministrave gjatë punësimit të kuadrove u lejojnë diskrecion të madh gjatë zgjedhjes, pavarësisht procedurave paraprake ose raportit nga komisionet për zgjedhjen e kandidatëve. “Madje 75% të qytetarëve në Serbi janë të mendimit se është i pamundur punësimi në administratën shtetërore vetëm përmes konkursit publik. Një përqindje e njëjtë e qytetarëve po ashtu janë të mendimit se nëpunësit janë jokompetentë dhe të prirur ndaj korrupsionit”, tha Vlladimir Mihajllloviq nga Qendra për Politikë Evropiane në Beograd, bashkëpunëtor i projektit Rrjeti 23+.

Si specifike e Ballkanit u theksua niveli i lartë i korrupsionit dhe ekzistimit të të ashtuquajturit “korrupsion i butë”. Sipas Dimitar Pehlivanov, ekspert nga Bullgaria, mospasja e besimit dhe kredibilitetit të institucioneve rezulton nga aktet normative në numër të madh. Për tejkalimin e këtij problemi nevojitet

---

<sup>11</sup>Mirënjohje për Kapacitetet e dobëta i vuri në pah edhe Dr. Rozeta Trajan, Sekretare e Përgjithshme e Komisionit.



të ndryshohet vetëdija shoqërore, meqë pa vetëdije të lartë sa i përket dëmit nga korrupsioni normat do të jenë çdoherë synim për abuzim. Sipas Dragan Malinovski, avokat dhe ish-anëtar i KSHPK, zgjedhjet në Maqedoni paraqesin luftë gladiatorësh, meqë përmes tyre i fitojnë institucionet, ndërsa opozita bëhet viktimë. **Nëse do të kishim institucione me kredibilitet dhe integritet, pushteti nuk do të ishte edhe aq atraktiv, pasi që institucionet do t'i trajtonin në mënyrë të barabartë të gjithë protagonistët/faktorët.** Sa i përket Maqedonisë, është evident dallimi i veprimit të protagonistëve politikë kur janë në opozitë dhe kur janë në pushtet. Çdo pushtet deri në një masë është rezistent ndaj kontrollit efektiv mbi punën e tij. Megjithatë, problemi më i madh është kur institucioni përgjegjës për parandalimin e korrupsionit i mbyll sytë para akteve evidente të korrupsionit nga ana e pushtetit, siç ishte rasti në të kaluarën.

Diskutuesit ranë dakord se për parandalimin e korrupsionit nevojiten institucione me kredibilitet dhe kapacitet për ta luftuar korrupsionin. Gjatë diskutimeve, disa herë, u theksua se **suksesi i luftës kundër korrupsionit më së shumti do të varet nga ekzistimi i vullnetit të mirëfilltë politik nga ana e protagonistëve relevantë politikë.** Deklarata e Kryeministrit Zoran Zaev për caktimin e anëtarëve jopartiak në KSHPK është një hap në këtë drejtim, megjithatë mbetet ta shohim implementimin e vërtetë të reformave që duhet të pasojnë në këtë fushë.

## Të drejtat themelore



Folës: **znj. Urania Pirovska**, Drejtoreshë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut; **z. Ixhet Memeti**, Avokat i Popullit; **znj. Mirjana L Lazarova Trajkovska**, ish-gjyqtare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe bashkëpunëtoresh e Universitetit Renmin në Kinë; **Prof. Dr. Natasha Gaber Damjanovska**, ish-gjyqtare Kushtetuese dhe u.d. Drejtoreshë e Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Juridike; **z. Aleksandar Nikollov**, drejtor i Asociacionit Zenit dhe ekspert i jashtëm i Aksionit të Grave – grantist i Rrjetit 23+; **znj. Radmilla Stojkovska Aleksova**, “Hapni Dritaret” – grantiste e Rrjetit 23+

Moderator: **z. Vasko Popetrevski**, gazetar

A do të kontribuojnë proceset reformuese në eliminimin e mangësive të sistemit, veçanërisht në institucionet kryesore të jurisprudencës dhe në institucionet e tjera të pavarura dhe trupat rregullatorë, ushtrimi i drejtë i kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore është me rëndësi kryesore për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut? Panel diskutimi i tretë ishte paramenduar t’u ofroj përgjigje çështjeve dhe dyshimeve kryesore për mbrojtjen e të drejtave fundamentale nga më shumë aspekte.

Në raportin [e fundit](#) të Komisionit Evropian u konstatua se krahas angazhimeve për implementimin e standardeve evropiane për mbrojtjen e të drejtave fundamentale, nevojiten angazhime shtesë për implementim adekuat dhe të plotë. Qëndrimi i këtillë u mbështet edhe nga diskutimi i Avokatit të Popullit, Ixhet Memeti, sipas të cilit Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ka një spektër mjaft të gjerë dhe bazë të konceptuar mirë për çdo gjë që i nënkupton liritë dhe të drejtat fundamentale të njeriut. Sipas Memetin, Republika e Maqedonisë nuk ia del që këto vlera të larta t’i zbatojë në mënyrë cilësore dhe në

mënyrë të mirë që të ndërtohet një sistem i cili mirëfilli do ta avancoj shoqërinë tonë.<sup>12</sup> Uranija Pirovska e theksoi rëndësinë e Rrjetit 23+ në procesin e krijimit të politikave dhe njoftimit të bashkësisë ndërkombëtare për gjendjet në Maqedoni. Ajo theksoi se Rrjeti 23+ ndihmoi që ta njoftoj publikun ndërkombëtar për aferën me përgjimet, për protestat e 5 majit, tejkalimet e autorizimeve policore dhe për paraburgimet të cilat gjatë viteve të kaluara aplikoheshin më shumë si dënim sesa si masë. Në këtë drejtim, është evidente se **një pjesë e madhe e çështjeve për të cilat raportonte Rrjeti 23+, të njëjtat bëheshin edhe pjesë të raporteve të Komisionit Evropian.** Në [Raportin e fundit për Republikën e Maqedonisë](#), Komisioni Evropian konstatoi se nevojiten angazhime për përmirësimin e gjendjeve nëpër burgje dhe në vendet e privimit nga liria. Në linjë të njëjtë ishin edhe qëndrimet e Avokatit të Popullit, sipas të cilit **sistemi i burgjeve përveç problemit me mbipopullimin dhe kushte johumane, ka edhe probleme të tjera serioze, siç është mënyra e menaxhimit të këtij sistemi.** Këto probleme serioze janë nënvizuar edhe në raportet e Komisionit Evropian, ndërkaq kanë të bëjnë me sistemin e rehabilitimit të të burgosurve dhe me rastet e vdekjeve në burgje. Sa i përket menaxhimit të burgjeve, u theksua se nevojitet ti vihet fund emërimeve partiake të udhëheqësve ose drejtorëve në këtë sistem. Përveç kësaj, u theksua se **Ligji për ngacmim në vendin e punës nuk e përmbush qëllimin e tij,** meqë mungojnë dispozita të cilat do t'u ofronin kompetencë inspektorëve që të hetojnë çështje të caktuara sipas denoncimit të qytetarit.<sup>13</sup>

Aleksandar Nikollov nga Asociacioni Zenit u përqendrua mbi reformat në lidhje me ndjekjen e komunikimeve në bazë të analizës „[Drejt Panoptikonit qytetar – baraspesha midis privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve](#)“. Ai theksoi se në ligjet e reja në mënyrë të detajuar është trajtuar përmbajtja e raporteve të PP në lidhje me ndjekjen e komunikimeve në bazë të masave hetuese. Është pranuar formimi i Këshillit për Kontroll Qytetar për ndjekjen e komunikimeve, janë rishikuar proceset për lëshimin e urdhrave urgjent për ndjekjen e telekomunikimeve, për të cilat kishte indikatorë se janë abuzuar nga ana e sistemit. Ajo që është **sfidë për AOT është fakti se një pjesë e nëpunësve të cilët do të punojnë në këtë Agjenci do të jenë persona të cilët aktualisht janë të punësuar në DSK.** Duhet të sigurohet debat për çmimin e kostos së këtyre reformave. Përveç kësaj nevojitet **harmonizimi me standardet e BE në lidhje me meta të dhënat.** Nikollov theksoi se me Ligjin e ri, u legalizua përdorimi i teknologjive të tjera alternative për ndjekjen e telekomunikimeve, që do të thotë metoda dhe mekanizma të rinj për ndjekjen e qytetarëve, ndërkaq kjo është bazë për shqetësim në lidhje me abuzimin e sistemeve të këtitilla.

Në Raportin e KE theksohet se nuk respektohen standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht sa u përket grupeve më vulnerable dhe të marginalizuara në shoqëri, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar. Në këtë drejtim, znj. Radmilla Stojkova Aleksova nga “Hapni dritaret” i prezantoi rezultatet nga [hulumtimi i zbatuar për aksesin dhe inkluzivitetin e gjykatave në Maqedoni.](#) Sipas hulumtimit, 59% e gjykatave kanë rampa të aksesshme në hyrjet e tyre. Sa u përket tualeteve, **vetëm 2 gjykata kanë tualet të aksesshëm për personat me aftësi të kufizuar,** megjithatë, testimi në praktikë tregoi se asnjë gjykatë nuk ka mundur kushte për një gjë të këtillë. Lidhur me ashensorët, vetëm 4 gjykata kanë ashensorë, ndërkohë që edhe ato që kanë, nuk i përmbushin standardet e aksesit sepse nuk kanë numra të cilët janë shënuar me alfabetin Braj. Për personat e verbër, 44% e gjykatave në pyetësin anketues janë përgjigjur se caktojnë person nga vet gjykata, i cili do t'i shoqëroj personat në situata të

---

<sup>12</sup>Ixhet Memeti, Avokat i Popullit.

<sup>13</sup>Ixhet Memeti, Avokat i Popullit.

nevojshme për ta realizuar shërbimin, ndërsa për personat me dëgjim të dëmtuar, nëse është e nevojshme, gjykata angazhon interpretues.

Në lidhje me institucionin Avokat i Popullit, Avokati i Popullit Ixhet Memeti theksoi se, sa i përket mbrojtjes individuale të qytetarëve, ky institucion pranon më shumë ankesa nga qytetarët në krahasim me vendet e tjera të rajonit, duke e marr parasysh numrin e popullsisë, e që vë në dukje atë se qytetarët kanë besim në këtë institucion. Avokati i Popullit theksoi se **ballafaqohet me problemin e implementimit të rekomandimeve të përgjithshme**, përkatësisht se Kuvendi duhet t'i merr parasysh rekomandimet dhe të kryej mbikëqyrje ose kontroll mbi pushtetin ekzekutiv.

Nevoja për **inkorporimin e ankesës kushtetuese në Republikën e Maqedonisë** u potencua nga Dr. Natasha Gaber Damjanovska. Sipas saj, kompetenca e këtillë e zgjeruar do të kontribuonte për mbrojtje më efektive të të drejtave themelore të qytetarëve, me qëllim të zbatimit efikas të drejtësisë. Përmes ankesës kushtetuese do të ketë edhe një mundësi që qytetarët, të drejtën e tyre, ta realizojnë në kuadër vendor, përpara se të shkojë çështja në GJEDNJ. Profesoresha e theksoi edhe nevojën e miratimit të **Rregullores së re të punës së Gjykatës Kushtetuese**. Teksti i ri do të ofronte zgjidhje të detajuara, jo vetëm për procedurën në Gjykatën Kushtetuese, por edhe gjatë prurjeve më të mëdha eventuale të lëndëve gjë që kërkon riorganizim të brendshëm të gjykatës, në kuptimin e asaj se a do të punoj në seanca plenare ose në këshilla në grupe më të vogla. Gjithashtu, ka edhe çështje të tjera të cilat janë në kuadër të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, e që nuk janë trajtuar mjaftueshëm në Rregulloren ekzistuese.<sup>14</sup> Ish-Gjyqtari Kushtetues, Igor Spirovski potencoi se autonomia e Gjykatës Kushtetuese dhe rezistenca ndaj presioneve vjen pikërisht nga Rregullorja e gjykatës.

Instanca e fundit dhe ombrella e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me punën dhe rolin e kësaj Gjykate diskutoi Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska. Sipas saj, numri<sup>15</sup> i aktgjykimeve të miratuara në fushën e jurisprudencës kundër Republikës së Maqedonisë është mjaft i lartë, krahasuar me numrin e aktgjykimeve kundër shteteve të cilat 50 vjet janë nënshkruese të kësaj Konvente. Fakti i këtillë e pasqyron gjendjen reale të shtetit në fushën e sistemit të jurisprudencës, ekonomisë dhe politikës. Maqedonia ka lëndë të cilat janë karakteristike për shekullit e 19-të, siç është tortura, trajtimi degradues dhe johuman. Ato janë lëndë të cilat drejtpërsëdrejti lidhen me problemin sistematik të policisë dhe prokurorisë dhe kjo ndodhë me vite. Faktet e këtilla pasqyrojnë një gjendje të **aplikimit permanent të forcës nga ana e policisë e cila përfundon me heshtjen e ngjarjeve ose me mosveprim nga ana e prokurorisë publike**. Republika e Maqedonisë ndoshta është një nga vendet e rralla në Evropë në të cilën përmendet KEDNJ, e sanksionuar në ligje, i referohen një numri të madh të ligjeve të praktikës gjyqësore të Konventës Evropiane, **megjithatë, në zbatimin praktik të standardeve dhe parimeve, gjyqtarët tanë dhe pjesëmarrësit e tjerë të sistemit të jurisprudencës, veçanërisht në prokurori dhe polici, shumë pak e njohin praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**.

---

<sup>14</sup>Në lidhje me këtë, znj. Gaber Damjanovska dha një shembull se nuk ka procedurë të detajuar për atë se si do të zhvillohej procedura eventuale për përgjegjësinë e Presidentit të shtetit.

<sup>15</sup>Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska: Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut gjatë 20 viteve për Maqedoninë miratoi 159 aktgjykime dhe disa qindra vendime, një pjesë e tyre për ujdj miqësore dhe marrëveshje unilaterale dhe kjo do të thotë gjithashtu cenime të konstatuara të cilat janë zgjidhur përmes ujdjës miqësore apo shteti ka pranuar se ka bërë cenim.

## Të drejtat e qytetarëve të BE



Folës: **z. Sasha Bogdanoviq**, kryetar i Komunës Qendër; **z. Dimitar Pehlivanov**, ekspert i integriteteve evropiane, Bullgari; **z. Ivan Novosel**, Shtëpia për të Drejtat e Njeriut, Kroaci; **znj. Arlinda Ilazi**, Multikultura – grantiste e Rrjetit 23+

Moderator: **z. Vasko Popetrevski**, gazetar

Gjatë kohës së këtij paneli u diskutua për të drejtat të cilat u përkasin qytetarëve, ndërsa më konkretisht për potencialin dhe përfshirjen e qytetarëve në krijimin dhe miratimin e vendimeve në nivel lokal, si dhe të drejtën e qytetarëve për ndihmë juridike falas.

Sa i përket involvimit të qytetarëve në politikat të cilat miratohen në nivel lokal, Bashkimi Evropian e stimulon përfshirjen e qytetarëve përmes së drejtave të garantuara të cilat inkorporohen që nga Traktati i Mاستriht-it. Të njëjtat fillimisht garantohen përmes direktivave dhe pastaj sanksionohen edhe në Traktatin e Lisbonës nga viti 2009. Këto të drejta, u mundësojnë qytetarëve të BE-së që të mund të votojnë në zgjedhjet lokale, kudo që ata jetojnë, pavarësisht se a janë shtetas të atij shteti. Në mënyrë plotësuese, ekziston edhe mundësia që qytetarët e BE-së, në shtete të caktuara, të kandidohen si kryetar komune edhe pse ky opsion mbetet e drejtë e diskrecionit të anëtarëve të BE-së. Në kuadër të këtyre të drejtave përshihet edhe e drejta që çdo qytetar i BE-së të kandidohet në zgjedhjet për anëtar të Parlamentit Evropian.

Për Maqedoninë si vend kandidat, i cili synon të ketë sistem funksional të decentralizuar të funksionimit dhe komuna të cilat janë në shërbim të qytetarëve, këto të drejta gjithashtu janë me interes. Në procesin

para-aderues, me rëndësi të veçantë është që komunat të përfshihen në informimin e qytetarëve për përfitimet nga BE, si dhe të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat u përkasin të gjithë qytetarëve të cilët automatikisht do të bëhen edhe qytetarë të BE-së. Në këtë drejtim, edhe autoritetet lokale duhet të përgatiten për mënyrën e punës të cilën e promovon BE, përkatësisht **komunat duhet të sigurojnë transparencë në punën e tyre në përputhje me udhëzimet e BE-së dhe parimet demokratike, si dhe të sigurojnë pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në marrjen e vendimeve**. Sasha Bogdanoviq, kryetar i Komunës Qendër potencoi se për këtë qëllim, bashkëpunojnë me organizatat qytetare të cilat i monitorojnë proceset eurointegruese, me çka i fuqizojnë kapacitetet e tyre, ndërkohë që mësojnë edhe nga përvojat e vendeve-anëtare të BE-së.

**Nga përvojat rajonale të Kroacisë dhe Bullgarisë nga anëtarësimi i tyre deri tani, mund shohim se ndoshta këto janë të drejta të qytetarëve më pak të zbatuara dhe realizuara.** Qytetarët thuaja se nuk e shfrytëzojnë fare të drejtën e kandidimit në zgjedhjet lokale, ndërsa qytetarët e BE-së të cilët jetojnë në këto vende rrallëherë votojnë në zgjedhjet lokale. Një nga shkaqet e kësaj dukurie është fakti se qytetarët nuk janë të informuar mjaftueshëm për këto të drejta. Sipas Dimitar Pehlivanov, përvoja pozitive e Bullgarisë është se megjithatë, edhe pse qytetarët nuk kandidohen në zgjedhjet lokale, megjithatë ata në mënyrë aktive përfshihen në jetën shoqërore. Përkatësisht, nëse cilido qoftë qytetar i dërgon një letër një institucioni në BE, përvoja e deritanishme në Bullgari konsiston me atë se menjëherë është reaguar. Në këtë kontekst, e drejta që t'u drejtohet institucioneve evropiane është e drejtë të cilën e përdorin organizatat qytetare dhe ndoshta ka efekt të ngadalshëm, por të fuqishëm. Rrjedhimisht me këtë, institucionet e BE-së i pezullojnë vendimet e gabuara të autoriteteve, dhe në këtë mënyrë gradualisht bëhen faktor në jetën e brendshme të Bullgarisë.

Përvojën të cilën Ivan Novosel nga Shtëpia për të Drejtat e Njeriut në Zagreb na e pasqyron është se këto të drejta nuk praktikohen fare në Kroaci. Nga viti 2013, kur shteti u bë anëtare i BE-së, deri më tani nuk ka pasur asnjë kandidat në zgjedhjet lokale (të zbatuara në vitin 2017) i cili nuk ka qenë shtetas i Kroacisë, ndërsa vetëm 25 qytetarë mobil të BE-së janë regjistruar me të drejtë pasive të zgjedhjes. Sipas të dhënave të fundit nga viti 2016, në Kroaci jetojnë mbi 12.000 qytetarë të BE-së. Në Kroaci, këto të drejta rregullohen me ligj të posaçëm, me çka shkohet një nivel më lartë, përkatësisht përveç që të kandidohen në nivel të komunës, qytetarët mund të kandidohen edhe në nivel rajonal, si dhe të votojnë gjatë kohës së referendumeve lokale.

**Konkluzioni lidhur me këtë çështje është se kjo është tendencë e cila ekziston jo vetëm në Kroaci dhe Bullgari, por në përgjithësi ekziston edhe në territorin e BE-së.** Niveli i daljes së ulët gjatë kohës së zgjedhjeve, ndërsa veçanërisht gjatë kohës së zgjedhjeve lokale është çështje dhe problem i cili duhet të shqyrtohet në kontekst më të gjerë. Për këto të drejta ekzistojnë dy probleme konkrete, përkatësisht **mosnjohja e mjaftueshme e politikave dhe kulturave nacionale, si dhe mosnjohja e funksionimit të institucioneve të BE-së. Barrierë plotësuese paraqet edhe mosnjohja e gjuhës lokale.**

Sa i përket ndihmës juridike falas, e drejtë të cilën tanimë e gëzojnë qytetarët e Republikës së Maqedonisë, u vu në dukje se niveli i përdorimit të kësaj të drejte është shqetësues. Sipas [hulumtimit të Multikultura](#), të cilin na e prezantoi Arlinda Ilazi, **prej tanimë më shumë se 8 vjet nga miratimi i Ligjit për ndihmë juridike falas, janë paraqitur më pak se 1000 kërkesa.** Në mënyrë plotësuese, Ligji nuk është harmonizuar me ligjet e tjerë dhe përmban norma të paqarta, për të cilat kompetentët nuk ofrojnë sqarime. Kërkesat për ndihmë juridike falas, të cilat edhe ashtu janë në numër të vogël, refuzohen për shkaqe të ndryshme dhe të pabazuara. Shoqatat të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas nuk kanë kurrfarë mbështetje për shpenzimet nga shteti, e që është edhe një nga shkaqet se pse nuk dëshirojnë të ofrojnë ndihmë juridike

falas. Megjithatë, nga ana tjetër, **është e ulët vetëdija e qytetarëve në lidhje me ekzistimin e ndihmës juridike falas.**

Konkluzioni konsiston me atë se duhet të gjendet mënyrë për promovimin e Ligjit, me qëllim që qytetarët të njoftohen me kushtet e realizimit të kësaj të drejte. Në mënyrë plotësuese, njëri nga rekomandimet është se duhet të sigurohet decentralizimi i miratimit të vendimeve për kërkesat për ndihmë juridike falas, sepse kjo do të ndihmonte në përmbushjen e sigurisë më të madhe juridike të qytetarëve, si dhe do të reduktohej kohëzgjatja e vendimmarrjes sipas këtyre kërkesave.